

Jeni të ftuar në: Samitin e Tranzicionit për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Lartë dhe Familjet e tyre, NYC, 2025

Jeni të përgatitur për jetën pas shkollës së mesme dhe hapat që vijnë më pas?

Na u bashkoni në **John Jay College** në Manhattan (524 W 59th St.) të shtunën, më 8 nëntor 2025 për **Samitin Mbarëqytetas të Tranzicionit për Nxënësit e Shkollave të Mesme të Lartë dhe Familjet e tyre**, të organizuar nga New York City Public Schools' Transition and College Access Centers (Qendrat e Tranzicionit dhe të Aksesit në Kolegje të New York City Public Schools (Shkollat Publike të Nju-Jorkut)), the Transition Alliance (Aleanca për Tranzicionin) dhe The City University of New York (Universiteti i Qytetit të Nju-Jorkut).

Ky eveniment fuqizues është dizajnuar për të mbështetur nxënësit me IEP ose plane 504 dhe familjet e tyre në planifikimin e tranzicionit, ndërsa përgatiten për jetën pas shkollës së mesme të lartë, duke përfshirë udhëzime dhe burime për kolegjin, karrierën ose jetesën e pavarur. Me dhjetëra ofrues shërbimesh nga mbarë bota e përgatitjes për jetën pas shkollës së mesme, duke përfshirë arsimin e lartë, programet profesionale, mbështetjen për punësim, shërbimet për jetesë të pavarur dhe organizatat komunitare — do të keni mundësinë të eksploroni një gamë të gjerë rrugëtimesh për jetën pas shkollës së mesme.

Çfarë mund të prisni në Samitin Mbarëqytetas të Tranzicionit 2025:

- Mundësi për të krijuar lidhje me kolegje, programe karriere, teknike dhe profesionale, ofrues shërbimesh, agjenci punësimi, organizata me bazë komunitetin, ofrues OPWDD dhe ekspertë të tranzicionit.
- Seminare tematike dhe konsultime individuale për tranzicionin.
- Burime të krijuara për të ndihmuar nxënësit dhe familjet të përgatiten për jetën pas shkollës së mesme.

Si të merrni pjesë

Ka dy mënyra të thjeshta për të na u bashkuar:

Duke u regjistruar online (preferohet):	Me anë të KODIT QR
Regjistrimi i pjesëmarrësve	

Pjesëmarrësit që vijnë pa regjistrim janë të mirëpritur: Mjafton të paraqiteni në eveniment ditën që do të zhvillohet dhe do të mund të merrni pjesë.